



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7651/2022
Data: 12.09.2022

PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tetë -VIII- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 18.08.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetari i Komunës), **Nexhmedin Daci** (Drejtorja për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Kimete Kuka –Hasallari** (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh për Administratë), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2022.
3. Plani i integritetit për vitin 2022-2026.
4. Plani i punës së tri Komitetet Konsultative për vitin 2022.
5. Propozim vendim me të cilin i mundësohet pronarëve të banesave të vjetra kolektive ndërtim i ri.
6. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2023.
7. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2021-2022.
8. Informatë për korrje shirjet.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë diskutim për rendin e punës.

Sherif Berisha thekson:- materiali për rregulloren për taksa dhe tarifa na është dërguar me vonesë dhe është mirë që të përcillen me kohë materialet, ndërsa pika e pestë e rendit të ditës kërkoj që të hiqet nga rendi i punës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- te raporti i kryetarit të komunës janë shënuar shumë projekte të cilat janë hartuar po është mirë që të na shpjegoni se cilat projekte kanë filluar me u realizuar.

Sevdi Dernjani thekson:- projekte të hartuara janë dhjetë projekte ne mund të sqarojmë secilin veç e veç, projekti i rrugës Krivenik-Gorancë është hartuar por nuk ka filluar me u realizuar por kërkesë i kemi parashtruar Ministrisë së Infrastrukturës për me na ndihmuar me mjete financiare, projekti i fazës finale te qendrës kulturore është finalizuar, projekti i kanalit të hapur në fshatin Paldenicë , projekti i mureve mbrojtëse , projekti i parkut të qytetit është hartuar dhe kanë filluar punimet për me u realizuar , projekti i rregullimit të hapësirave për rreth komunës ka filluar me u realizuar , projekti i aneksit shtesë te Ura e Seçishtës , projekti i vendosjes së ashensorit në komunë , projekti i shtrimit të rrugicave në zonën urbane dhe rurale , projekti i asfaltimit të rrugës Ramuk-Paldenicë është në procedurë nga Ministria e Infrastrukturës.

Sherif Berisha thekson:-te projekti përreth postës për dy apo tri metra nuk ua keni dërguar kupëzat lokaleve aty. Çka do të bëhet me pronën private që është mbrapa komunës në të cilën keni punuar.

Nexhmedin Daci thekson:- pronarët e lokaleve zhvillojnë biznese dhe duhet të investojnë në rregullimin e hapësirës para lokalit. Me pronarin e pronës private kemi bërë marrëveshje për shpronësim.

Refet Kalisi thekson:- nuk jam i kënaqur me fillimin e projekteve sidomos para bizneseve ja ka humbur pamjen edhe ato kupëza që janë vendosur dhe po që se ka pasur mundësi komuna me rregulluar ka qenë mirë sepse janë hequr kupëzat e vjetra dhe janë vendosur të reja e shihet që është më mirë . Projekti para komunës është mirë që është realizuar por është mirë me reaguat për me u kryer më shpejtë dhe sistemin pikë pikë është dashur me bërë për të gjithë drunjtë. Nuk janë vendosur anësoret të kupëzat që është bërë katrori për shkak se nëse nuk vendosen munden mu zgjeruar kupëzat. Fontanën nuk e kisha mbuluar me dhe por më mirë e kisha demoluar krejt .

Nexhmedin Daci thekson:- sa i prekët realizimit të projektit ju gjithë e dini që ai e ka kontratën dhe nuk mund ta detyrojmë për me i kryer punimet dhe kompania e ka bërë porosinë e drunjve dhe ka premtuar që brenda dy apo tri dite do të vijnë. Sa i përket vendosjes së anësoreve do ta shikoj se a i ka në paramas. Sa i përket fontanës kemi plan tjetër për vitet e ardhshme por është bërë vetëm një zgjidhje kaluese për shkak se kjo është donacion.

Kryesuesi thekson:- çfarë marrëveshje është bërë për pronën private.

Nexhmedin Daci thekson:- marrëveshje kemi bërë për me mbjell gjelbërim dhe kemi bërë pa kompensim. Komuna në vitin 2010 ka bërë kontratë për shpronësim por nuk ka mundur me i dhënë diku pronë, tash e kemi vazhduar marrëveshjen edhe për tri vite për me bërë shpronësimin.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR PERIU DHËN JANAR-QERSHOR 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Plani i integritetit për vitin 2022-2026.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- ky plan është hartuar në bashkëpunim me OSB-në dhe të njëjtin e ka hartuar nëpër tërë komunat e Kosovës. Nëse keni ndonjë propozim rreth këtij dokumenti mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- drejtorit të cilat i kanë paraqitur raportet , çfarë masa munden me marr gjatë vërshimeve apo në raste të tërmeteve.

Natyra Kalisi thekson:- drejtoria për shërbime publike i ka paraparë masat në plan që do të merren në raste të caktuara.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLANI I INTEGRITETIT PËR VITIN 2022-2026 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Plani i punës së tri Komitetet Konsultative për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- materialin e planit të punës së komiteteve konsultative e keni pasur dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLANI I PUNËS SË TRI KOMITETET KONSULTATIVE PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Propozim vendim me të cilin i mundësohet pronarëve të banesave të vjetra kolektive ndërtim i ri.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- bëhet fjalë për ndërtesat e vjetra të cilat janë në gjendje të mjerueshme të cilat realisht bëjnë një kërcënim seriozë për shëndetin e atyre banorëve. Përmes këtij propozimi kemi menduar që pronarëve të këtyre banesave qoftë vetë apo edhe në bashkëpunim me investitorët me bërë ndërtime të reja në pajtim me panin rregullues urban ndërsa statusi i pronës nuk ndryshon edhe pse realisht ajo pronë është e tyre por ka shumë paqartësi për shkak se në kadastër prona figuron si pronë e Komunës , mirëpo askund në botë nuk ka që shtëpia me qenë private e prona me qenë e shtetit. Te ne kjo ka mbetur për shkak se Ligji i Privatizimit të banesave i ndërtesave kolektive ka hyrë në fuqi në vitin 1993 dhe banorët i kanë blerë banesat por në momentin që i kanë blerë prona ka mbetur pronë shoqërore ndërsa banesa private. Zgjidhje tjetër për këto ndërtesa nuk kemi, por edhe ndonjë opsion me të mirë nuk kemi, mirëpo po tentojmë përmes këtij propozim vendimi që me ju krijuar kushte këtyre banorëve që vetë me ndërtuar apo në bashkëpunim me investitorë me bërë ndërtime të reja.

Kryesuesi thekson:- a mund të na jepni sqarim më në detale sepse kjo çështje nuk është e lehtë.

Nexhmedin Daci thekson:- është Ligji mbi të drejtat themelore pronësore që është i ish Jugosllavisë i cili është në fuqi, neni 12 i këtij ligji potencon që në rastet kur banesa është private ndërsa prona është e shoqërisë pronari e ka në shfrytëzim të përhershëm dhe shfrytëzimi i përhershëm i bien sikur me qenë pronarë dhe herdo kurdo kur hekë dorë me automatizëm prona i kthehet komunës pra nuk ka ligj që mundesh me i larguar. Është ligji tjetër i cili nuk zbatohet në Kosovë por i cili është në fuqi për shkak se Kosova nuk ka ligj të tokës ndërtimore , ndërsa ligji tokës ndërtimore i vitit 1986 potencon që përparësi ndërtimore kanë banorët. Ligji për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi i Republikës së Kosovës neni 36 përgjegjësitë e Komunës ndaj ndërtesave në bashkëpronësi i cili potencon se komuna me anë të planeve rregulluese përcakton tokën e përbashkët , hapësirat publike në funksion të ndërtesave në bashkëpronësi. Pika dy e këtij neni potencon se nëse ndërtesa në bashkëpronësi, parcela në të cilën është ndërtuar është pjesërisht ose tërësisht pronë komunale, komuna duhet të pajtohet gjatë procesit të regjistrimit të bashkëpronësisë në dhënien e titullit pronarë të njërive ndaj hapësirave të përbashkëta në funksion të ndërtesës të rregulluara sipas paragrafit një të këtij neni. Është edhe draft ligji i tokës ndërtimore i Republikës së Kosovës të cilin në vitin 2018 na e kanë përcjell dhe me sa jam në dioni është në procedurat e miratimit në Kuvend. Në aspektin ligjorë dikush mund të thotë që toka figuron e komunës ndërsa në aspektin real nuk ka lidhje sepse në qoftë se dikush tenton me paraqitë si tokë reale të komunës atëherë shtrohet pyetja pse na nuk ju thojm këtyre pronarëve që heknin këto banesa e dërgoni diku tjetër dhe naj ktheni tokën

Kryesuesi thekson:- unë mendoj që të gjithë e kemi një mendim pozitivë për këta banesa që duhet me i rinovuar apo me i ndërtuar të reja sepse ndoshta nuk kanë siguri por është mirë që me qenë të rehatuar me ligj për shkak se nuk është mirë me bërë diçka e ndoshta nesër banorët me pasur probleme.

Sherif Berisha thekson:- kur kam kërkuar që të bëhet fasadimi i këtyre banesave keni potencuar që në prona private nuk mundemi me investuar , ndërsa tash potenconi se vlejnjë ligjet e ish Jugosllavisë dhe të qeverisë.

Nexhmedin Daci thekson:- nuk është mirë që të merren gjërat me paragjykitime sepse për atë nuk është investuar qe njëzet e pesë vite. Me këtë çështje qe tre vite jam duke u marr me ish kryetarin e komunës kemi qenë në Ministri për këtë çështje. Sa i përket lyerjes të gjithë e dini që banesa është private.

Sevdi Dernjani thekson:- nëse keni dyshimi lirishtë mundeni me përcjellë rastin konkretë që është duke u bërë në Shqipëri pra investime milionëshe dhe është e njëjta situatë gati e njëjtë sikur te rasti jonë në Han të Elezit , investimet kanë me u bërë por prona ka me qenë diskutabile kurse ndërtesat kanë me qenë të kompanisë. Personat të cilët kanë me i blerë banesat kanë me qenë bashkëpronarë të atij objekti dhe realisht nuk ka kuptim që me qenë pronarë i banesë dhe jo i tokës , pra e njëjta situatë ka me qenë edhe te na. Kush e ka në pronësi banesën ka me qenë edhe i pronës pra këtu është dallimi.

Sherif Berisha thekson:- ne i kemi ligjet e Kosovës dhe nuk kemi nevojë për ish të Jugosllavisë.

Nexhmedin Daci thekson:- e kemi rregulloren e UNMIK-ut që i ka shfuqizuar ligjet diskriminuese të ish Jugosllavisë dhe ligj të tokës ndërtimore komuna nuk ka.

Kryesuesi thekson:- komuna a përfiton në këtë rast dhe nuk dua të bëjë fajtor ty si drejtorë por këtu ka mendime që të bëjnë me dyshuar dhe a mundemi me dyshuar dhe me menduar gabim mundemi, mirëpo për derisa nuk përfiton komuna këtu diçka nuk është në rregull. Si kryesues i kuvendit vetë kam hasur në dyshimet e mia dhe i kam dërguar imell adresë zyrtarit ligjorë me më dhënë përgjigje për këtë pikë të rendit të punës paraprakisht se a është në rregull me ligjin por ende nuk më ka kthyer përgjigje. I kam dërguar imell adresë edhe zyrtarëve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal por nuk më janë përgjigjur që do të thotë se diçka nuk është e qartë . Si kryesues i kuvendit nuk jam për me votuar këtë pikë të rendit të punës dhe secili në përgjegjësi të vetën ne ta merr. Qëllimi dhe vullneti jot si drejtorë është i mirë sepse këtyre banesave diçka duhet të ju bëjmë por mendimi imë është që me pritur deri sa të rregullohet ligji dhe me votuar ashtu siç duhet.

Nexhmedin Daci thekson:- dyshimet kanë me ekzistuar sa të funksionon komuna dhe nuk mundemi proceset me i ndal pse dikush dyshon dhe nëse dyshoni në mu unë ndoshta mund të bëjë ndonjë vepër penale dhe mund të përfundoj në burg dhe nuk duhet të bëheni merak ju sepse nuk keni nevojë për me u bërë merak. Edhe njëherë po e potencojë që ligjet nuk e qartësojnë dhe kjo është absurd dhe nëse i shikoni ish shtetet e Jugosllavisë një sistem ka qenë po të gjitha i kanë kryer këto punë.

Sherif Berisha thekson:- është mirë që këtë me bërë për të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret. Si LVV nuk e votojmë këtë pikë dhe kemi me u munduar me të gjitha mekanizmat që mos me kaluar sepse ka shumë shkelje. Lista është dorëzuar nga drejtoria e urbanizmit me 18.09.2020 dhe kërkojmë që kjo pikë mos të votohet dhe të hiqet prej rendit të punës.

Nora Xhoni thekson:- a është marr pëlqimi i banorëve të cilët banojnë në ato banesa.

Nexhmedin Daci thekson:- ka pasur banorë të ndërtesave që kanë kërkuar par tri apo katër viteve për me bërë ndërtime të reja dhe nuk kemi mundur me i dhënë përgjigje që me ndërtuar apo mos me ndërtuar. Kompania Alba ka bërë marrëveshje me banorët e ndërtesës që është afër shkollës së mesme “Dardania” por nuk kemi mundur me i dhënë leje ndërtimore. Ka interesime të tjera për barakat por nuk jam në gjendje me i dhënë leje ndërtimore.

Refet Kalisi thekson:- unë jam për me dhënë lejen për ndërtim por vërejtje kam që është shënuar rruga “Xhemsedin Suma” disa janë paraparë katër katëshe , e disa gjashtë katëshe dhe pse nuk janë krejt gjashtë katëshe. Dyshimet e mija janë te prona për shkak se komuna nuk përfiton.

Nexhmedin Daci thekson:- është numri i njësive banesore dhe leja ndërtimore duhet të ipet në pajtim me planin rregullues.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit dy kundër, dy abstenim (prezent ishin katër anëtarë të KPF-së).

6. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- të gjitha propozimet të cilat janë dhënë për me u ndryshuar janë të bazuara në ligj dhe në udhëzime administrative . Nëse keni ndonjë propozim mundeni me propozuar.

Sherif Berisha thekson:- te drejtoria e shërbimeve publike a ka ndonjë ndryshim. Terminali e di që është në procedura gjyqësore me komunë por edhe pse është në procedurë a është duke i kryer pagesat. A është bërë ndonjë pagesë për shfrytëzim të hapësirave komunale prej ndonjë individi që merret me sport.

Majlinda Kaloshi thekson:-te drejtoria për shërbime publike i kemi dy taksa të reja është dëmtimi i drunjve dhe bimëve dekorative , dëmtimi i tabelave digjitale. Terminali është ende në proces gjyqësorë. Nuk kam ndonjë informacion se dikush që merret me sport që ka paguar ndonjë taks.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

7. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2021-2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI SUKSESIN E ARRITUR TË NXËNËSVE NË SHFMU DHE SHML NË FUND QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Informatë për korrje shirjet.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Abduraman Bushi thekson:- në informatë janë paraqitur të dhënat të cilat janë më të rëndësishme. Përveç këtij materiali diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:- a do të subvencionohen bujqit për mbjelljet vjeshtore.

Abduraman Bushi thekson:- nuk mund të subvencionohen për shkak se në këtë vit e kemi subvencionuar grurin dhe një kulturë nuk mund të subvencionohet dy herë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA PËR KORRJE SHIRJE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- te varrezat e dëshmorëve mungojnë dy ulëse është mirë mi shikuar. Donacion i kemi pasur dymbëdhjetë ulëse dhe mund ti përdorim dikund. Duhet të rregullohet agregati te çerdhja për shkak se po kemi reduktime të rrymës dhe duhet ti bëhet një mbulojë agregatit. Drejtoria për shëndetësi a ka filluar ndonjë procedurë për barna esenciale. Hekurat të cilët janë vendosur para postës është mirë mi hequr me vendosur një tabelë dhe policia me u marr me atë çështje për shkak se po ja humb pamjen.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- edhe pse nuk kemi marr ndonjë rekomandim që është mënyrë e drejtë jemi duke vepruar siç është vepruar më herët për shkak se është në pyetje shëndeti i qytetarëve.

Sherif Berisha thekson:- duhet të kontaktoni me drejtoreshën e QKMF-së për me u respektuar orari i punës. Ka raste që gjatë orarit të punës punëtorët rrinë nëpër kafiteri.

Nexhmedin Daci thekson:- hekurat janë vendosur për shkak se kemi pasur kërkesë nga qytetarët po ashtu një pjesë ja përcaktuam postës dhe përmes asaj rruge veturat hyshin dhe u parkojshin në atë pjesë dhe u dashtë me mbyllë edhe atë pjesë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 12:53.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

